



## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit V. L., për shkak të veprës penale “Vjedhje”, nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë- dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.200/22, të datës 29.09.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.688/2023, të datës 28.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 26.03.2024, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit V. L. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.200/22, të datës 29.09.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.688/2023, të datës 28.09.2023.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.200/22, të datës 29.09.2022, i dënuari V. L., është shpall fajtor për shkak të veprës penale “Vjedhje”, nga neni 313, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej treqind (200) Euro, të cilën gjobë do ta paguaj në afat prej 3 muaj nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast se i dënuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku një ditë burgim do ti llogaritet me 20 € gjobë.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.688/23022, të datës 28.09.2023, i ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankesën e të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

-Mbrojtësja e të dënuarit, avokate Ylberza Glllogjani Krasniqi, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa të dënuarit ti hiqen dënimet e shqiptuara.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.101/2024, e datës 18.03.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësja e të dënuarit pretendon se aktgjykimet përmbajnë shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat pretendime i ka cituar edhe në ankesë. Më tutje në kërkesë thekson se Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë ndaj të dënuarit V. L. për kryerjen e veprës penale të vjedhjes nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK dhe ky dyshim i Prokurorisë bazohet vetëm në deklaratën e palës së dëmtuar dhe nuk ka asnjë prove tjetër të vetme me të cilën do të vërtetohet dyshimi se i dënuari ka ndërmarrë veprime në kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë. Theksohet në kërkesë se i dënuari ka probleme shëndetësore-psiqike dhe gjykata e bëri pranimin e fajësisë pa u bindur se i dënuari e kupton pranimin e fajësisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizojë pretendimet e mbrojtëses të të dënuarit V. L. , konstatojë se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesë.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë përpiluar në formën e parashikuar me ligj, pasi që përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore.

Dispozitivi i këtyre aktgjykimeve është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe nuk është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin e këtyre aktgjykimeve.

Në anën tjetër, nga procesverbali i shqyrtimit fillestar, rezulton se i dënuari V. L., paraprakisht ishte udhëzuar për të gjitha të drejtat e tij, duke përfshirë këtu edhe për mundësinë e pranimit të fajësisë, si dhe për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë.

Pas këtyre udhëzimeve, i dënuari V. L. e kishte pranuar fajësinë, ndërsa gjykata e shkallës së parë e kishte miratuar këtë pranim të fajësisë, siç është theksuar edhe më lart, duke konsideruar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për një të tillë.

Lidhur me pretendimin e mbrojtëses të dënuarit, se i dënuari vuan nga problemet shëndetësore psikike, kjo gjykatë vlerëson se pretendimi është i pabazuar për faktin se nga shkresat e lëndës nuk rezulton se i njëjti është trajtuar ndonjëherë lidhur me shëndetin mendor e as që në këtë drejtim ka ndonjë provë që do të vërtetonte se i dënuari është person me probleme të shëndetit mendor.

Edhe pse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur për shkelje të ligjit penal mirëpo nga përmbajtja e saj, janë paraqitur pretendime edhe për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike,

Ndërsa, sa u përket pretendimeve lidhur me gjendjen faktike, konform nenit 432, paragrafi 2. të KPP, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, andaj edhe rrjedhimisht pretendimet e tilla të mbrojtësit të të dënuarit nuk janë shqyrtuar fare.

Andaj, nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.176/2024, më datë 26.03.2024

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Mejreme Memaj